



**Perspektiva juaj
është sfida jonë!**

Fondi më i ri në fushën e investimeve

Raport Muaji Qershor 2025

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	LEK
Datë Lancimi	20 Gusht 2018
Datë e mbarimit te Ofertes Fillestare	03 Shtator 2018
Vlera fillestare e kuotës	1,000
Shuma fillestare minimale	30,000
Shuma minimale pasuese	10,000

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0%
Tarifë në dalje	1% (cdo shlyerje para 2 viteve)
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.15% e vleres neto te aseteve

Tarifa te tjera te vazhdueshme

Komisione/tarifa e vazhdueshme

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta

Referojuni prospektit te fondit

1.28% per vitin 2024

Referojuni informacionit ne deget e RBAL

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të maksimizoje kthimin total afatmesëm, duke synuar të ruajë kapitalin e investitorit dhe të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm.

Fondi synon të ketë një portofol investimesh të përqëndruar kryesisht në instrumente borxhi të emetuara ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

Për të maksimizuar kthimin total nga investimi, Fondi synon investime afatgjata dhe për këtë arsye, fondi investon të paktën 50 – 80% të aseteve ne obligacione afatgjatë te Qeverisë shqiptare.


Shifra e tarifas së vazhdueshme 1.28% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2024. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund te kalojë maksimumin prej 1.4% ne vit te vlerës neto të aseteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë
Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i Riskut dhe Përfitimit të fondit Raiffeisen Vizion i përket kategorisë së tretë. Ky nivel i treguesit është rezultat i aplikimit të politikës së investimit të fondit me të dhënat historike të normave të interesit për 5 vitet e fundit. Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk. Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 30.06.2025

Vlera Neto e Aseteve	11,866,529,741
Numri i investitoreve	4,278
Cmimi i Kuotes	1,308.1197
*Kthimi vjetor neto nga investimi (30.06.2024 – 30.06.2025)	9.35%

*Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 30 Qershor 2025



Ne kuader të politikës së investimit të fondit Vizion, investimet kryhen kryesisht në obligacione thesari, të emetuara ose garantuara nga Qeveria shqiptare, përmes pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar dhe transaksioneve në tregun sekondar.

Politika e investimit parashikon që të paktën 50 – 80 % e asetëve të fondit të investohen në obligacione afatgjate të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Fondi mban një pjesë të asetëve në depozita afatshkurtra për të plotësuar në çdo kohë nevojat për likuiditet të investitoreve. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin e LEK 11.9 miliardë në datë 30 Qershor 2025.

Instrumenti	Në % të Asetëve të Fondit
Obligacione Thesari	88.7%
Depozita / Llogari rrjedhese/ Të arketueshme	11.3%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here në muaj; Obligacionet 2 vjeçare një here në muaj; 10 dhe 15 vjeçare janë me të rralla, afersisht një here në tre muaj. Qeveria organizon ankande të obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuencë një here në muaj për secilin maturitet.

Zhvillimet dhe ecuria e normave te interesit te titujve te Qeverise Shqiptare gjate muajit Qershor


Gjate muajit Qershor norma bazë e interesit është e pandryshuar në nivelin 2.75%. Nderkohe, norma e inflacionit mbetet në nivele të ulëta dhe nën kontroll sipas Bankës së Shqipërisë.

Asetet e Fondit Vizion janë të investuara vetëm në bono dhe obligacione të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe për këtë arsye fondi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në normat e interesit të këtyre titujve.

Normat e interesit të titujve të emetuar nga Qeveria Shqiptare kanë ndjekur një trend rrites gjatë muajit Qershor. Yieldi i Bonos së Thesarit 12-mujore rezultoi në 2.758% duke u rritur me 0.03% në krahasim me ankandin e muajit Maj.

Përsa i përket obligacioneve në krahasim me ankandet e fundit: Yieldi i obligacionit 2 vjeçar rezultoi në 2.85%, i njëjti me ankandin paraardhës; Yieldi i obligacionit reference 3 vjeçar rezultoi në 3.009% duke u rritur me 0.03%; Yieldi i obligacionit reference 5 vjeçar rezultoi në 3.502% duke u rritur me 0.18%; Yieldi i obligacionit 7 vjeçar rezultoi në 3.97% duke u rritur me 0.04% dhe Yieldi i obligacionit 10 vjeçar rezultoi në 4.700% duke u rritur me 0.35%.

Grafiket më poshtë japin një pasqyrë të ecurisë së normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të thesarit të emetuar nga Qeveria Shqiptare gjatë periudhës 1-vjeçare Qershor 2024 – Qershor 2025. Për obligacionet reference 3 dhe 5 vjeçare janë paraqitur yield-et fikse të përlogaritura nga kuotimet e kontributoreve në fund të muajit Qershor.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 30 Qershor 2025

Kthimi neto me baze vjetore, për periudhën 30 Qershor 2024 – 30 Qershor 2025 është 9.35%.

Çmimi i kuotës së fondit Vizion ka rënë lehtë me **-0.03%** gjatë muajit Qershor. Rritja e normave të interesit për obligacionet e Qeverisë Shqiptare, sidomos ato afatgjata ka ndikuar negativisht në portofolin e investimeve të fondit Vizion.


Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varesi të kushteve të tregut, sic janë ndryshimet e normave të interesit të titujve të borxhit të emetuar nga Qeveria Shqiptare. Kështu kur normat e interesit në treg rriten, vlera e titujve të portofolit ulët dhe për rrjedhojë ulët dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen. Për pasojë, çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi i saj është i pamundur, kështu çmimi i kuotës mund edhe të bjere, jo vetëm të rritet.

Ecuria e çmimit të kuotës Fondi Raiffeisen Vizion



Ne 30 Qershor 2025	1 Vit	2 Vjet	3 Vjet	5 Vjet	Qe nga lancimi i fondit (3 Shtator 2018)
Ne % kthim vjetor i periudhes (p.a.)	9.35%	6.54%	5.63%	4.16%	4.01%

Kthimi vjetor historik i Fondit Raiffeisen Vizion per çdo vit



Fondi Vizion aplikon nje periudhe minimale qendrimi ne fond prej 2 vitesh. Për çdo shlyerje apo këmbim të kryer përpara përfundimit të periudhës minimale të investimit prej 2 vitesh, do të aplikohet tarifë dalëse. Kjo tarifë është 1% për investimet e kryera në fond nga data 15 Janar 2025.

Pertej minimumit kohor te qendrimit ne fond, Investitorët e fondit Vizion dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter. Per fondin Vizion ky horizont i rekomanduar i qendrimit ne fond eshte te pakten 3 vjet, duke patur parasysh natyrën afatgjatë të investimeve të parashikuara në strategjinë e investimit të fondit dhe ne menyre qe te permbushet objektivi i performancës së fondit. Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Të dhënat per kthimin nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premim apo garanci per kthimin ne te ardhmen. Te gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitorët per te nxjerre konkluzione per te ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë nje kthim te caktuar te fondit. Informacioni mbi cmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.